



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 23

2003

Prill

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9027 datë 13.3.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes".....	709
Ligj nr.9028 datë 13.3.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për rregullimin e procedurave të ndërtimit, pajisjes dhe plotësimit me personel të spitalit ushtarak të Gjirokastrës".....	716
Ligj nr.9029 datë 13.3.2003	Për disa shtesa në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile".....	727
Ligj nr.9030 datë 13.3.2003	Për një shtesë në ligjin nr.8240, datë 10.4.1997 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998 dhe me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001.....	729

Vendim i KM nr.196, datë 20.3.2003	Për standardet e zhvillimit të kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional.....	730
Vendim i KM nr.211, datë 28.3.2003	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga rehabilitimi i segmentit rrugor Bogovë-Çorovodë, në qarkun e Beratit.....	731

L I G J
Nr.9027, datë 13.3.2003

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË
REPUBLIKËS SË GREQISË PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT USHTARAK DHE
CIVIL SHQIPTAR NË QENDRËN STËRVITORE NDËRKOMBËTARE PËR
OPERACIONET MBËSHTETËSE TË PAQES"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3753, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS GREKE**

“Për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe/ose civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes”

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë e njohur si “Palë” dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës Greke tani e në vazhdim e njohur si “Pala pritëse” dhe tani e në vazhdim të quajtura si “Palë”:

duke pasur parasysh që bashkëpunimi politiko-ushtarak mbështetet në elementet bazë për të rritur aftësitë e OKB-së;

duke pasur parasysh që bashkëpunimi i dyanshëm do të kontribuojë për stabilitetin në Europë dhe do të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve;

duke pasur besimin se do të ekzistojë një zhvillim i tillë në bashkëpunim dhe dialogim ndërmjet shteteve të lidhura me operacionet mbështetëse për paqen tani dhe në vazhdim të njohura si “PSOs”;

duke dëshiruar të kontribuojnë për përmirësimin e stërvitjeve dhe ndërveprimeve të Forcave të Armatosura të tyre në përputhje me kërkesat e reja operacionale të “PSOs”;

duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja NATO-SOFA-PfP dhe protokolleve plotësuese, e cila u nënshkrua në Bruksel, më 19 janar 1995,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të krijojë një strukturë ligjore, e cila është e nevojshme për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes (MPSOTC) tani dhe në vazhdim e njohur si “Qendra”.

Neni 2

Parimet kryesore

1. “Pala pritëse” merr përsipër që të sigurojë instalimet/lehtësitë e kërkuara, infrastrukturën e duhur për sistemet mbështetëse të komunikacionit dhe informacionit, ashtu si dhe logjistikat e nevojshme për të bërë të mundur funksionimin e Qendrës dhe përmbushjen e misionit të saj.

2. Palët sigurojnë që aktivitetet e Qendrës të jenë në përputhje me qëllimet dhe parimet kryesore të OKB-së.

3. Pjesëmarrja në aktivitetet e Qendrës nuk është e drejtuar kundër ndonjë shteti tjetër dhe gjithashtu nuk ka si qëllim që të stërvisë personelin ose forcat ushtarake kundër çdo shteti tjetër ose grup shtetesh.

4. Stërvitja e ofruar në Qendër do të jetë transparente, kalendari akademik do të jetë i siguar në kohë nga Pala pritëse në përputhje me kërkesat e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Aktivitetet e Qendrës janë në përputhje me parimet bazë të OSBE-së, të cilat janë të përfshira gjithashtu në Marrëveshjen e Pfp-së. Këto aktivitete do të ndihmojnë në stërvitjen e individëve dhe grupeve të Palës në kompletimin e operacionet e mbështetjes së paqes të propozuara për ta, nga organizatat ndërkombëtare.

6. Kjo Marrëveshje nuk do të prejë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga traktatet ose Marrëveshjet që ata kanë nënshkruar më parë.

Pala pritëse mban të drejtën e plotë të fillojë diskutimet për të nënshkruar dhe marrëveshje të tjera bilaterale, me natyrë të njëjtë, me shtete të tjera ose organizata ndërkombëtare. Pala do të informohet rreth nënshkrimit të disa marrëveshjeve të tilla.

8. Gjuha e punës në Qendër do të jetë gjuha angleze.

Neni 3

Misioni i Qendrës

1. Misioni i Qendrës është të sigurojë nivel të lartë edukimi teorik, praktik, si dhe trajnime të skuadrave dhe të trupave ndërkombëtare, për operacionet e mbështetjes së paqes në përputhje me standardet e organizatave përkatëse ndërkombëtare të tilla si OKB, OSBE, NATO, BE.

2. Qendra, në bazë të një plani të përcaktuar të misionit, merr përsipër të sigurojë stërvitjet e orientuara, në të gjitha aspektet e operacionet e mbështetjes së paqes, të oficerëve të stafit vëzhgues ushtarak dhe kontingjenteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të sigurojë vendqëndrimet e tyre, para se të bëhet planizimi për një mision specifik.

Neni 4

Organizimi

1. Qendra është një strukturë e pajisur me personel në tri degë të FA-së greke, e cila është nën kontrollin e Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare të Palës pritëse.

2. Tabela e organizimit të Qendrës është në aneksin A, e cila është modifikuar nga Pala pritëse në përputhje me kërkesat e funksionimit të Qendrës.

3. Personeli i përhershëm (mësimor dhe administrativ i Qendrës) do të përbëhet nga personel ushtarak nga forcat tokësore, ajrore dhe detare ashtu si dhe personel civil.

4. Pala pritëse do të sigurojë të gjithë personelin e nevojshëm ushtarak dhe civil, përveç pozicioneve të mëposhtme të cilat duhet të plotësohen me personel ndërkombëtar:

a) oficerët e stafit;

- b) instruktorët.
- 5. Pala duhet të sigurojë instruktorë në bazë të një memorandumit mirëkuptimi.
- 6. Pala ka të drejtën të tërheqë nga Qendra, instruktorin e përmendur më lart, vetëm pas njoftimit zyrtar me shkrim, i cili i bëhet Palës pritëse të paktën 30 ditë para ditës së caktuar për të bërë tërheqjen.

Neni 5 Stërvitja

- 1. Qendra do të sigurojë kurset si më poshtë vijon:
 - a) Kursin ndërkombëtar të oficerëve për operacionet e mbështetjes së paqes (Kursi bazë dhe i avancuar).
 - 1. Kohëzgjatja: dy javë.
 - 2. Numri i kurseve për vit: 4 (katër).
 - 3. Është përgatitur për oficerët e rinj dhe madhorë (Trajnim i trajnuesve).
 - 4. Qëllimi i kursit është që t'i stërvisë dhe t'i përgatisë oficerët për operacionet e mbështetjes së paqes, e lidhur kjo me detyrat dhe përgatitjen si vëzhgues ushtarak, mbikëqyrësit e zgjedhur ose për misione të tjera mbështetëse të organizatave ndërkombëtare të tilla si: OKB, NATO, OSBE dhe BE.
 - 5. Pjesëmarrja maksimale kombëtare për kursin: 5 oficerë trajnues.
 - b) Kursi i kompanive ndërkombëtare për operacionet e mbështetjes së paqes (Kursi bazë dhe i avancuar).
 - 1. Kohëzgjatja 2 javë: gjatë javës së parë, stërvitja do të zhvillohet për çdo togë, ndërsa gjatë javës së dytë, për çdo kompani.
 - 2. Numri i kurseve për vit: 2 (dy).
 - 3. Qëllimi i kursit është të stërvisë, togat dhe kompanitë për pjesëmarrje në operacionet e mbështetjes së paqes, si dhe në formacionet kombëtare dhe në ato ndërkombëtare dhe të sigurojë detyrat e nevojshme të përshtatshme përpara zhvillimit të stërvitjes. Programi i kursit siguron mësimet teorike dhe praktike të drejtimit në klasë dhe në terren.
 - 4. Minimumi i pjesëmarrjes së një vendi: organika e një toge.
 - c) Kursi ndërkombëtar për operacionet e mbështetjes së paqes për logjistikën.
 - 1. Kohëzgjatja: 1 javë.
 - 2. Numri i kurseve për 1 vit: 1 (një).
 - 3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe përgatisë oficerë nga vende të ndryshme për caktimin si oficerë shtabi logjistik të shtabit të brigadës ose në shtabet shumëkombëshe mbështetëse dhe/ose në kontingjentet kombëtare për drejtimin e operacioneve të mbështetjes së paqes.
 - 4. Kursi do të sigurojë mësimet teorike dhe praktike brenda në klasë në pikat e komandimit dhe në terren.
 - 5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.
 - d) Inspektorët e CFE/shoqërues.
 - 1. Kohëzgjatja: 2 javë.
 - 2. Numri i kurseve për një vit: 1 (një).
 - 3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të përgatisë oficerë dhe personelin në kryerjen e detyrave si inspektorë dhe shoqërues, siç është parashikuar në Traktatin e Forcave Konvencionale të Europës (CFE).
 - 4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike.
 - 5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.
 - e) Kursi i vëzhguesve ushtarakë.
 - 1. Kohëzgjatja: 1 javë.
 - 2. Numri i kurseve për një vit: 1 (një).
 - 3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të përgatisë oficerë nga vende të ndryshme si vëzhgues ushtarakë në operacionet e mbështetjes së paqes dhe të njohë të trajnuarit me procedurat e komandimit-drejtimit të strukturës së NATO-s, procedurat dhe standardet e punës dhe terminologjinë.
 - 4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike, drejtohet në klasë dhe jashtë saj.
 - 5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.

- f) Kontrolli i kufirit/kursi i sigurimit.
 Kohëzgjatja: 1 javë.
 Numri i kurseve për një vit: 1 (një).
3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të njohë oficerë dhe nënoficerë nga vende të ndryshme në të gjitha aspektet e regjimit të kontrollit të kufirit, të jenë të aftë të vendosin, organizojnë, plotësojnë me njerëz, pajisje dhe stërvisin njësitë e kontrollit të kufirit.
4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike, në klasë dhe në terren.
5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.
2. Në diplomim të trajnuarit do të marrin certifikatën zyrtare të kursit të përgatitur nga Qendra.
3. Në muajin maj të çdo viti, Pala pritëse duhet t'i sigurojë kalendarin akademik për vitin e ardhshëm, Palës dhe organizatave përkatëse ndërkombëtare.
4. Kushtet e këtij neni, mund të ndryshohen në çdo kohë nga Pala pritëse, e cila është e detyruar të lajmërojë Palën të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara hyrjes në fuqi të kushteve të reja.

Neni 6 **Procedurat**

1. Të gjitha informacionet që lidhen me numrin e pjesëmarrësve dhe procedurat e transportimit, të drejtën e armatimit gjatë hyrjes dhe daljes, si dhe detaje të tjera do të sigurohen nga një trupë përgjegjëse e cila bashkë me trupën përkatëse të Palës pritëse, do të përcaktojnë dhe bëjnë të mundur planin për marrjen dhe transportimin e personelit nga pika hyrëse në Qendër.
2. Informacioni i mësipërm do të paraqitet në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare Greke të paktën një muaj përpara datës së mbërritjes së personelit shqiptar dhe do të publikohet në një "Raport të përbashkët" të Palëve.
3. Pala duhet të dërgojë në Qendër, informacionet për organikën, pajisjet e plota të trupave që do të stërviten për togat ose kompanitë. Në këtë rast ajo do të konsultohet me Palën pritëse për strukturën e kontingjentit të saj, si dhe për të gjitha detajet që lidhen me mbërritjen, sistemimin dhe nisjen.
4. Qendra ka të drejtën ekzkluzive që gjatë kursit të organizojë stërvitjen, me qëllim që të krijojë kushtet e përshtatshme për drejtimin e stërvitjes.
5. Largimet ose mungesat e paarsyeshme nuk janë të lejuara gjatë kursit. Në situata emergjente dhe pas një njoftimi me shkrim nga autoritetet përgjegjëse të Palës, Komandanti i Qendrës mund të lejojë lëvizje të shkurtra për secilën Palë, si për Greqinë, ashtu edhe për shtetin e origjinës.
6. Të trajnuarit gjatë kursit, do të mbajnë uniformat e shërbimit ose uniformat e stërvitjes, të cilat do të jenë të përcaktuara në planin kalendarik të kursit.
7. Të trajnuarit e huaj duhet të pajtohen me rregullat e sigurimit të Palës pritëse.

Neni 7 **Juridiksioni**

1. Statusi ligjor i personelit të dërguar nga Pala në territorin grek, sipas Marrëveshjes aktuale, duhet të udhëhiqet nga Marrëveshja ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shtetet e tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe mbështetur në statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 19 janar 1995.
2. Komandanti i Qendrës ka kompetencë të nxjerrë urdhra, në lidhje me funksionimin e Qendrës. Këto urdhra janë të vlefshëm edhe për të gjithë personelin trajnues. Personeli shqiptar duhet të zbatojë dhe t'i respektojë këto urdhra, për aq sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.
3. Bazat e komandimit dhe të disiplinës të çdo kontingjenti kombëtar të Palës, janë në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.
4. Korrespondenca zyrtare e Qendrës me Palën do të bëhet nëpërmjet drejtorisë përkatëse.

Neni 8 **Mbështetja e shtetit pritës**

1. Pala pritëse është përgjegjëse për të siguruar mbështetje logjistike dhe administrative për një funksionim sa më të mirë të Qendrës.

2. Detajet e nevojshme që kanë të bëjnë me “Mbështetjen kombëtare pritëse” do të jenë përcaktuar në një memorandum mirëkuptimi të nënshkruar nga të dy Palët.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhen me konsultime direkte ndërmjet Palëve, pa iu drejtuar një pale të tretë.

Neni 10

Ndryshime

1. Palët kanë të drejtë të propozojnë me shkrim, ndryshime për ndonjë nga nenet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Në qoftë se bien dakord të dy Palët, këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Propozimet në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 2 dhe nenin 5, paragrafi 4 të Marrëveshjes.

Ndryshimet e propozuara në pikën 3 të këtij neni, nuk do të mund të kenë efekte të njëanshme për Palën pritëse.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Marrëveshja, si dhe aneksi “A” pjesë e pandarë e saj, hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, në formë të shkruar, se kanë mbaruar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar, në qoftë se asnjëra nga palët nuk e ka denoncuar me anë të njoftimit përmes kanaleve diplomatike të paktën 6 muaj para datës së dëshiruar për përfundimin e Marrëveshjes.

2. Në rastin kur të drejtat dhe detyrimet financiare mbeten të pazgjidhura në momentin e përfundimit, kushtet e Marrëveshjes që kanë të bëjnë me to do të mbeten në fuqi, derisa detyrimet financiare të jenë përmbushur përfundimisht nga Palët.

Kjo Marrëveshje (së bashku me aneksin “A”) hartohet në tri kopje origjinale, përkatësisht në gjuhën shqipe, greke dhe angleze duke qenë të gjitha tekstet autentike. Në rast se konstatohen ndryshime në këto gjuhë, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Athinë, më 25 nëntor 2002.

PËR MINISTRINË E MBROJTJES SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Gjeneral Brigade Luan Hoxha
Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë dhe
Integritimit

PËR MINISTRINË E MBROJTJES KOMBËTARE
TË REPUBLIKËS SË GREQISË

K/admiral Konstantinos Pahqis
Drejtor i Përgatitjes në Shtabin e Përgjithshëm të
Mbrotjtjes Kombëtare

L I G J
Nr.9028, datë 13.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES TEKNIKE NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR RREGULLIMIN E PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT, PAJISJES DHE PLOTËSIMIT ME PERSONEL TË SPITALIT USHTARAK TË GJIROKASTRËS”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për rregullimin e procedurave të ndërtimit, pajisjes dhe plotësimit me personel të spitalit ushtarak të Gjirokastrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3754, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
TEKNIKE NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË “PËR RREGULLIMIN E PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT, PAJISJES DHE PLOTËSIMIT ME PERSONEL TË SPITALIT USHTARAK TË GJIROKASTRËS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, e cila në vazhdim do të quhet “Pala shqiptare” dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë, e cila në vazhdim do të quhet “Pala greke” dhe që të dyja së bashku do të quhen “Palë”:

duke pasur parasysh objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, konkretisht parimin e ndalimit të dhunës ose shantazhit për përdorim dhune në marrëdhëniet reciproke, duke respektuar të drejtat sovrane, mosshkeljen e kufijve, sovranitetin tokësor, të mosndërhyrjes në çështjet e brendshme dhe rregullimin paqësor të mosmarrëveshjeve;

duke respektuar angazhimet që u adaptuan në bazë të Aktit Final të Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë, të Kartës së Parisit dhe të Dokumentit të Vjenës më 1994, si dhe të dokumenteve të tjera të OSBE-së;

duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja NATO-SOFA-PfP dhe protokolleve plotësuese, i cili u nënshkrua në Bruksel, më 19 qershor 1995, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995;

duke synuar zbatimin në marrëdhëniet dypalëshe të dokumentit të negociatave mbi masat e krijimit të besueshmërisë dhe sigurisë, që u adaptua në Vjenë më 1994, masa të tjera për krijimin e besueshmërisë dhe të sigurisë;

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë që u nënshkrua në Athinë, më 7 nëntor 1992, duke pasur parasysh protokollin për ndihmën dhe bashkëpunimin për Forcat e Armatosura ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë që u nënshkrua në Tiranë, më 5 gusht 1997;

me dëshirën për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre,
Palët ranë dakord përsa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve reciproke që Palët marrin përsipër për vënien në zbatim të projektit për ndërtimin e spitalit ushtarak të Gjirokastrës, të procedurave që do të ndiqen dhe rregullimin e detajeve të nevojshme në lidhje me punimet e ndërtimit, pajisjes dhe plotësimit me personel të spitalit, projekt i cili realizohet në kuadrin e ndihmës dhe bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët janë dakord të bashkëpunojnë në harmoni për zbatimin normal të gjithë projektit që përfshin punimet e ndërtimit të spitalit ushtarak të Gjirokastrës, procedurat e transportimit dhe të vendosjes së pajisjeve të nevojshme për ambientet konkrete të spitalit që përmenden më sipër dhe plotësimit me personel të përshtatshëm shkencor dhe ndihmës për funksionimin pa pengesa të tij, që janë dhënia e shërbimeve shëndetësore dhe mjekime të nivelit të lartë në dobi të personelit ushtarak të forcave të armatosura shqiptare dhe të qytetarëve të zonës.

Bashkëpunimi i sipërpërmendur ndërmjet Palëve do të përfshijë fushat e përgjithshme të mëposhtme:

- Transportim dhe ruajtje të materialeve dhe mjeteve të nevojshme për ndërtimin e spitalit ushtarak të Gjirokastrës.

- Transporti, vendosja dhe ruajtja e pajisjeve që do të sillen nga Pala greke për nevojat e spitalit ushtarak të Gjirokastrës.

- Lehtësira dhe siguri për personelin e Palës greke, që do të ndërtojë dhe do të pajisë spitalin ushtarak të Gjirokastrës.

- Lehtësira për Konsullatën e Përgjithshme të Gjirokastrës për mbulimin shëndetësor dhe mjekimin në spitalin ushtarak të Gjirokastrës për personelin e saj që ajo do të propozojë tek drejtoria kompetente e spitalit ushtarak të Gjirokastrës.

- Bashkëpunim shkencor i spitalit ushtarak të Gjirokastrës me spitalin ushtarak 401 të Athinës, nën monitorimin e drejtorive shëndetësore kompetente të shtabeve të përgjithshme të dy Palëve për përmirësimin e vazhdueshëm të dhënies së shërbimeve shëndetësore të mjekimit.

Neni 3

Ndërtimi dhe përbërja e spitalit ushtarak të Gjirokastrës

Spitali ushtarak i Gjirokastrës ndërtohet nga Pala greke brenda territorit të ish-divizionit të Gjirokastrës dhe do të monitorohet nga autoritetet kompetente të Palës shqiptare dhe asaj greke.

Ndërtesa e spitalit përbëhet nga kati i parë me sipërfaqe 1000 m², bodrumi me sipërfaqe 300 m², me kapacitet 40 shtretër dhe përfshin të gjithë sektorët e nevojshëm, si godinën dhe pajisje për funksionimin e tij. Në këtë spital do të përfshihen ambientet për pritjen e pacientëve, administrimit të materialeve dhe të lëvizjes së automjeteve. Përveç ndërtesës, ndërtohen gjithashtu dhe hyrjet e

nevojshme, si muri mbështetës, depozitë uji, depozitë banje, vendvendosje hidrosanitare, vendvendosje gjeneratori dhe rregullimi i territorit përreth, si dhe do të mbështetet lidhja me rrjetet e ujit dhe energjisë elektrike, për të cilat Pala shqiptare merr përsipër detyrimin që të sigurojë burimet (lidhjet) përkatëse.

Kostoja e përgjithshme e veprës arrin shumë prej 1 760 822 euro (600 000 000 dhrahmi). Punimet për ndërtimin e përgjithshëm të spitalit ushtarak të Gjirokastrës do të përfundojnë deri në fund të dhjetorit 2002.

Neni 4

Pajisja e spitalit ushtarak të Gjirokastrës

Pala greke merr përsipër pajisjen e plotë të spitalit ushtarak të Gjirokastrës me pajisje mjekësore dhe hotelerie, ashtu siç është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje, si pjesë e pandarë e saj.

Kostoja e pajisjes së mësipërme do të arrijë shumë rreth 880411 euro (300 milionë dhrahmi) dhe gjykohet se ndërtimi dhe funksionimi i tij do të bëhet në fund të dhjetorit 2002.

Aparatet mjekësore dhe materialet që do të futen në Shqipëri dhe që destinohen për mbështetjen dhe pajisjen e spitalit ushtarak të Gjirokastrës do t'i jepen Palës shqiptare në formën e ndihmës dhe/ose dhuratë, të cilat do të përjashtohen nga taksat dhe detyrimet doganore.

Pala shqiptare merr përsipër detyrimin që të ofrojë çdo ndihmë të mundshme, gjatë transportimit të çdo lloj materiali dhe personeli nga pika e hyrjes në territorin shqiptar deri në spitalin në fjalë. Pala greke do të informojë dy ditë më parë Palën shqiptare për dhënien e kontributit.

Pala shqiptare merr përsipër detyrimin e ruajtjes së ndërtesës dhe të pajisjeve.

Neni 5

Plotësimi me personel i spitalit ushtarak të Gjirokastrës

Pala greke merr përsipër detyrimin për plotësimin me personel të përshtatshëm mjekësor, spitalor, ndihmës për spitalin ushtarak të Gjirokastrës në vitin e parë të funksionimit të tij.

Numri i personelit mjekësor të Palës greke prej 41-vetësh (mjekë, infermierë) përcaktohet në aneksin B, i cili është pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje. Përcaktimi i numrit të personelit mjekësor shqiptar vendoset nga Pala shqiptare.

Personeli i mësipërm i Palës greke do të sigurojë funksionimin normal të spitalit ushtarak të Gjirokastrës për një periudhë kohore prej një (1) viti ose edhe më tej, në qoftë se do të bien dakord të dyja Palët dhe paralelisht do të trajnohet personeli i Palës shqiptare, me qëllim që të sigurojë funksionimin normal të spitalit ushtarak të Gjirokastrës edhe pas përfundimit të këtij afati.

Personeli i Palës greke do të punojë së bashku me personelin shqiptar mbi bazën e një rregulloreje të hartuar dhe pranuar nga Palët.

Spitali ushtarak i Gjirokastrës gjatë periudhës kohore që do të përbëhet nga personeli i Palës shqiptare dhe Palës greke do të ketë mundësitë e mëposhtme:

- zbatimin e 4 ose 6 ndërhyrjeve të vogla gjatë 8 orëve, në varësi të kushteve, nga sektori i operacioneve të spitalit;

- vizita nga klinika e jashtme e sektorëve të patologjisë dhe kirurgjisë së spitalit edhe nga ora 8.30-14.00 të ditëve që punohet, për njëzet (20) persona për çdo pavion;

- kryerjen e 100 (njëqind) radiografive për çdo ditë dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) deri në 20 (njëzet) ECHO të organeve të ndryshme, të zemrës dhe të enëve, nga sektori radiografik i spitalit;

- kryerjen deri më 200 (dyqind) analiza hematologjike dhe biokimike për çdo ditë nga laboratoriu mikrobiologjik dhe biokimik i spitalit;

- dhënien e mjekimit dentist për 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 20 (njëzet) persona për çdo ditë nga klinika dentare e spitalit;

- mjekimin e pacientëve në dhoma me kapacitet 40 (dyzet) shtretër.

Pala greke merr përsipër detyrimin për sigurimin e materialit mjekësor, farmaceutik dhe ushqimin për pacientët e spitalit ushtarak të Gjirokastrës gjatë periudhës kohore që do të shërbejë edhe personeli i saj, sipas aneksit B të kësaj Marrëveshjeje.

Pala shqiptare merr përsipër detyrimin për:

- mbulimin e nevojave të spitalit ushtarak të Gjirokastrës me ujë, lëndë djegëse, energji elektrike dhe telekomunikacion, si dhe të disponimit të personelit të nevojshëm ndihmës për funksionimin normal të spitalit ushtarak të Gjirokastrës në sektorët si për shembull të përkthimit, të mirëmbajtjes, të pastrimit etj;

- lehtësira në gjetjen e shtëpive, të cilat do të përdoren për qëndrimin e personelit të Palës greke;

- mbulimin me personel të nevojshëm për ruajtjen e spitalit ushtarak të Gjirokastrës dhe sigurinë e personelit gjatë kohës kur është në punë, në bashkëpunim me drejtorinë e tij.

Pas mbarimit të kohës së shërbimit nga personeli i Palës greke në spitalin ushtarak të Gjirokastrës do të rrinë te drejtoria e këtij spitali 2 (dy) mjekë të Palës greke dhe në kushte pariteti do të vendosen në spitalin e përgjithshëm ushtarak 401 të Athinës 2 (dy) mjekë të Palës shqiptare, të cilët do të shërbejnë si koordinatorë ndërmjet spitalit ushtarak të Gjirokastrës dhe autoriteteve kompetente ushtarake greke të shëndetësisë, si dhe spitalit të përgjithshëm ushtarak 401 të Athinës.

Të mësipërmit do të shërbejnë tek spitali ushtarak i Gjirokastrës dhe tek spitali i përgjithshëm ushtarak 401 i Athinës, për një periudhë kohore një (1) vjeçare nga data e largimit të personelit të Palës greke. Pas përfundimit të afatit një vjeçar, qëndrimi i mëtejshëm i mjekëve grekë do të rinovohet me pëlqimin e Palëve, të cilat për këtë qëllim negociojnë 30 ditë përpara përfundimit të këtij afati.

Të dy Palët do të ndryshojnë personelin e tyre, në bazë të gjykimit të tyre për arsye shërbimi, për arsye shëndetësore ose për arsye të paparashikuara. Në raste të tilla do të informohet Pala tjetër me shkrim në lidhje me të dhënat për personelin që do të zëvendësohet dhe datën e zëvendësimit të tyre. Numri i përgjithshëm i personelit të Palëve do të jetë i qëndrueshëm dhe në bazë të rregullave që përcaktohen në këtë Marrëveshje, përveç rastit kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 6

Bashkëpunimi i spitalit ushtarak të Gjirokastrës me spitalin e përgjithshëm ushtarak 401 të Athinës

Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve në çështje shëndetësore dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore në spitalin ushtarak të Gjirokastrës, ndërmjet spitalit ushtarak të Gjirokastrës dhe spitalit të përgjithshëm ushtarak 401 të Athinës, nën monitorimin e Palës greke, Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

- Fusha e trajnimit:

Dhënia nga Pala greke e programeve mësimore, bibliografi e materiale ndihmëse për personelin e spitalit ushtarak të Gjirokastrës, si dhe kryerjen e sesioneve shkencore.

- Fusha mjekësore:

Dërgimi çdo dy muaj për një periudhë kohore prej 5 (pesë) ditësh, 4 (katër) mjekë specialistë dhe 2 (dy) infermiere nga spitali i përgjithshëm ushtarak 401 i Athinës, në spitalin ushtarak të Gjirokastrës për ndihmë në klinikën e jashtme të spitalit dhe dhënie trajnimi dhe këshillash tek personeli i spitalit.

Komunikimi telefonik ndërmjet spitalit ushtarak të Gjirokastrës dhe spitalit të përgjithshëm ushtarak 401 të Athinës do të realizohet për raste emergjent, që mund t'i interesojnë spitalit ushtarak të Gjirokastrës.

Çështjet konkrete të bashkëpunimit do të përcaktohen çdo vit pas takimit të drejtorëve të spitaleve të sipërpërmendura dhe do të jenë objekt i nënshkrimit për programin e bashkëpunimit për vitin e ardhshëm. Takimi i sipërpërmendur i të dy drejtorëve do të realizohet brenda muajit tetor të çdo viti, ndërsa programi i bashkëpunimit do të nënshkruhet deri në fund të nëntorit të çdo viti.

Pala greke në kuadrin e bashkëpunimit dhe brenda mundësive të saj do të akordojë të drejta pasuniversitare studimi pas kërkesës së Palës shqiptare, për mbulimin e nevojave të spitalit ushtarak të Gjirokastrës me personel mjekësor dhe spitalor.

Neni 7

Statusi ligjor i personelit

Çështjet ligjore të personelit të Palës greke gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri dhe të personelit të Palës shqiptare gjatë qëndrimit të tyre në Greqi, në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, do të

trajtohen në bazë të PpP SOFA (Marrëveshje ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s dhe të vendeve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqen në lidhje me statusin e forcave të tyre, që u nënshkrua në Bruksel, më 19 qershor 1995).

Neni 8

Mbrojtja e informacioneve të klasifikuara

Palët sigurojnë mbrojtjen e informacioneve të të dhënave që përfitohen nga takimet dypalëshe duke përfshirë edhe të dhënat sekrete dhe detyrohen të mos bëjnë përdorim të tyre pa miratimin me shkrim më parë të Palës, që i disponon këto informacione, si dhe të mos i transmetohen këto informacione një pale të tretë.

Informacionet gojore dhe të shkruara që përfitohen nga takimet dypalëshe ruhen sipas legjislacionit shtetëror në fuqi të secilës Palë dhe nuk duhet të publikohen te mediat.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet direkt nga Palët, nëpërmjet konsultave reciproke dhe pa i'u drejtuar një pale të tretë.

Neni 10

Ndryshimet

Secila Palë mund të propozojë me shkrim ndryshime në cilëndo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje. Në këto raste, Palët do të kryejnë bisedime brenda 30 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës për ndryshime. Ndryshimet e mundshme do të hyjnë në fuqi nga data kur të dy palët informojnë njëra-tjetrën me shkrim, për pranimin e ndryshimeve të bëra.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, ditën e marrjes së njoftimit nëpërmjet të cilit Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Rinovimi i kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet me pëlqimin e Palëve, të cilat për këtë qëllim fillojnë bisedimet 60 ditë përpara përfundimit të afatit 5-vjeçar.

Neni 13

Gjuha dhe nënshkrimi

Kjo marrëveshje bëhet në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, greke dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet autentike.

Në rast se konstatohen ndryshime në këto gjuhë, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

“A” Tabelë me aparate shëndetësore dhe material konsumues ose jo, i cili do të jepet nga Pala greke për spitalin ushtarak të Gjirokastrës.

“B” Tabelë analize e personelit mjeko-spitalor dhe ndihmës i Palës greke sipas detyrës dhe profilit që do të përbëjë personelin e spitalit ushtarak të Gjirokastrës.

PJESA “A” E KËSAJ MARRËVESHJEJE

TABELË ME MEKANIZMAT MJEKËSORE DHE MATERIAL TJETËR KONSUMUES
OSE JO I CILI DO TË JEPET NGA PALA GREKE PËR SPITALIN USHTARAK TË
GJIROKASTRËS

Nr.	AO	PËRSHKRIMI I MATERIALIT	SASIA	VËREJTJE
∇	∃	α	*	γ
		MATERIAL RADIOLOGJIK		
1		Aparat radiologjik	1	
2		Aparat automatik stampimi i filmit radiologjik	1	
3		Kuti vështrimi i filmave radiologjikë	1	
4		Veshje mbrojtëse nga rrezet prej plumbi për personelin 0,5 mm	1	
5		Mbajtëse pllakash radiografike, plastike me tabela përforcuese me shpejtësi të madhe 35,6x43,6 cm	2	
6		Mbajtëse pllakash radiografike, plastike me tabela përforcuese me shpejtësi të madhe 35,6x35,6 cm	2	
7		Mbajtëse pllakash radiografike, plastike me tabela përforcuese me shpejtësi të madhe 24x30 cm	2	
8		Mbajtëse pllakash radiografike, plastike me tabela përforcuese me shpejtësi të madhe 18x24 cm	1	
9		Llambë për dhomën e errët radiologjike tavani	1	
10		Film radiografik 35x43	300	
11		Film radiografik 35-36x35-36 cm	200	
12		Film radiografik 24x30 cm	200	
13		Film radiografik 18x24	100	
14		Dosje karteke arkivi për trajtimin dhe për filmat radiografikë 36x45 cm	500	
15		Lëng me tretës për përgatitjen e solucionit stampimit automatik	200	
16		Lëng me tretës për përgatitjen e solucionit stampimit automatik	200	
		MATERIAL MIKROBIOLOGJIK-DHËNIA E GJAKUT		
17		Mikroskop dyokular, komplet	1	
18		Analit automat hematologjik	1	
19		Analit (zbërthyes) biokimik automat i “i kimisë së thatë”	1	
20		Tavolinë centrifuge elektrike	1	
21		Mikrocentrifuge hematokrite	1	
22		Lavazh uji	1	
23		Analit automat elektrolit me elektrodë të jonizuar	1	
24		Peshore elektronike me përpikmëri të lartë	1	
25		Frigorifer elektrik	1	
26		Ngrirës	1	
27		Frigorifer për qeset e gjakut	1	
28		Klavë elektrike inkubatore	1	
29		Pipette automatike 100 ml	1	
30		Pipette automatike 200 ml	1	
31		Pipette automatike 1000 ml	1	
32		Pipette automatike 10-200 ml	1	
33		Pipette automatike 200-1000 ml	1	

34		Kronometër 1/10 sek	1	
35		Kronometër tavoline 1 orë	1	
36		Karrige për marrje gjaku	1	
37		Tavolina me rrota	1	
38		Set raktivësh të analitit hematologjik		
39		Set reaktivësh të analitit elektrolitësh	2	
40		Reaktive analiti "të kimisë së thatë"	2	
		KIRURGJIA-MATERIAL-ANESTEZIA		
41		Aparat anestezik me maskë frymëmarrjeje automatike	2	
42		Tavolinë kirurgjike elektrike-hidraulike	1	
43		Projektor kirurgjie tavani		
44		Llambë tavani skialitike me satelitë	1	
45		Fibrator me monitor dhe regjistrues	1	
46		Regjistrues tymi	1	
47		Elektrokardi me tre kanale	1	
48		Oksimetër pulsi	1	
49		Monitor hemodinamik dhe ndjekës i zemrës	1	
50		Trapan ajri për kirurgji kockash		
51		Njësi elektrokirurgjike (Ngrohëse kirurgji)	1	
52		Klavë për sterilizimin e lëngshëm (autodjegëse)	1	
53		Analit i gazrave të gjakut		
54		Lavatriçe të veglave kirurgjikale	1	
55		Thithje kirurgjikale	2	
		MATERIAL DENTAR		
56		Njësi dentare e plotë (UNIT)	1	
57		Aparat dentar radiografik	1	
58		Klavë sterilizimi veglash (autodjegëse)	1	
59		Aparat të retinave fotopolimerike	1	
60		Aparat ECHO për heqje gazrash	1	
61		Përzier amalgamesh	1	
62		Aparat me stampim automat të pllakave dentare	1	
63		Mbajtës veglash i lëvizshëm	1	
		MATERIAL SPITALOR		
64		Elektrokardiogram	1	
65		Maskë portarine	1	
66		Oksimetër pulsi, portativ	1	
67		Fibrator portativ me monitor dhe regjistrues	1	
68		Aparat elektronik tensioni automatik	1	
69		Monitor portativ të pikave jetike (parametrave)	1	
70		Monitor elektrokardiogrami	1	
71		Klavë sterilizimi të thatë	1	
72		Llambë rrezatimi ultraviolet	1	
73		Statinë dyshemeje e lëvizshme	20	
74		Paravan me rrota	6	
75		Aparat për larje skoramidesh	2	
76		Mbajtëse diagramesh të pacientit	25	
77		Stativë për marrje gjaku	1	
78		Frigorifer shtëpiak për ilaçe	1	
79		Transportues rrobash me rrota	2	
80		Transportues gjelle	1	
81		Transportues ndryshimi	4	
82		Krevat vizitash	2	
83		Projektor për ndriçim dyshemeje me rrota	2	

84		Karrige invalidi	4	
85		Barrelë me stativë për transportin e të sëmurëve	4	
		FARMACI		
86		Frigorifer për mbajtjen e ilaçeve	1	
87		Ngrirës-mbajtës i ilaçeve	1	
88		Rafte DEXOON për magazinimin e barnave 20x2, 20x0.3-0.4 m		
89		Vitrinë ilaçesh		
		PAJISJE TË TJERA		
90		Tavolinë (zyre)	10	
91		Dollape zyre me dy dyer	10	
92		Karrige zyre të lëvizshme dhe me mbështetëse anësore	15	
93		Karrige të thjeshta metalike	50	
94		Karrige salloni të thjeshta	20	
95		Tavolina të vogla të thjeshta salloni	15	
96		Divane 3 vendësh për dhomën e pritjes	5	
97		Divane 4 vendësh për dhomën e pritjes	2	
98		Divane 2 vendësh	5	
99		Karrige për dhoma	9	
100		Vaskë banje		
101		Perde	?	
102		Krevatë spitali (të lëvizshme këmbët,krahët)	22	
103		Dysheqe	22	
104		Komodina me tavolinë të vogël që paloset	22	
105		Jastëqe	40	
106		Këllëfë jastëku	100	
107		Çarçafë të bardha	200	
108		Batanije prej leshi ngjyrë blu	80	
109		Batanije pikë të bardha	44	
110		Pizhame pacientësh dimërore	66	
111		Pizhame pacientësh verore	66	
112		Peceta banje	50	
113		Peceta fytyre	50	
114		Veshje për pacientët	44	
115		Kazanë mbeturinash	10	
116		Kosha për mbeturinat	20	
		MATERIAL KUZHINE-RESTORANTI		
117		Furrë profesionale me dy kate dhe dhomë ngrohjeje	1	
118		Kuzhinë profesionale	1	
119		Makinë për prerjen e mishit	1	
120		Fritezë profesionale	1	
121		Dërrasë për prerjen e mishit	1	
122		Dhomë ngrohje	1	
123		Rafte për mbajtjen e gjërave (gotave etj)	1	
124		Tavolinë prej inoxi me raft dhe dyer të lëvizshme	1	
125		Llanxhë për larjen e enëve	1	
126		Llanxhë për dy larje të enëve	1	
127		Frigorifer i ushqimeve	1	
128		Ngrirës ushqimesh	1	
129		Lavatriçe pjatash-tabakave-profesionale	1	
130		Tavolinë restoranti për 4 veta	6	
131		Karrige restoranti	24	
		KAFENE		

132		Frigorifer	1	
133		Tavolina	4	
134		Karrige	10	
		LAVATRIÇE		
135		Lavatriçe profesionale	1	
136		Tharëse profesionale	1	
137		Hekurues profesional	1	

PJESA “B” E MARRËVESHJES TEKNIKE

TABELË-ANALIZË E PERSONELIT MJEKËSOR-SPITALOR DHE NDIHMES E PALËS
GREKE SIPAS DETYRAVE DHE PROFILIT I CILI DO TË PËRBËJË KUADRIN E
SPITALIT USHTARAK TË GJIROKASTRËS

DETYRA-PROFILI	B	Nr
1.Oficerë		
Komandantë	Oficer (K3)	1
Shefi i shërbimit në spital	Oficer (K;)	1
Drejtor i sektorit Pathologjik (Patholog)	Oficer (K3)	1
Drejtor i sektorit kirurgjik (Kirurg)	Oficer (K3)	1
Drejtor i sektorit të anesteziës (Anestizues)	Oficer (K3)	1
Drejtor i Sektorit dentar (Dentist)	Oficer (KO)	1
Infermieri/a (Pathologji)	Oficer (KN)	1
Ndihmësmjek AE (Kirurgji)	Oficer (K3)	1
Ndihmësmjek AE (Pathologji)	Oficer (K3)	1
Drejtor i farmacisë (Farmacist)	Oficer (KN)	1
Infermier i kirurgjisë	Oficer (KN)	2
Drejtues	Aspirant	1
Totali		13
2. (Ushtarë/Nënoficerë)		
Kryerreshter në krye të grupit	K3	1
Administrues i materialeve	K3	1
Kryetëknik H/Y i organeve dhe i mirëmbajtjes së godinave	K3	1
Ndihmësinfermiere (Pathologjisë)	K3	1
Ndihmësinfermiere (Pathologjisë)	K3	1
Administrues material	K3	1
,494σ9ηζ (Nënoficer ABX i dizinfektimit)	K3	1
Ndihmës i anestizuesit	K3	1
Ndihmësinfermier (Kirurgji)	K3	1
Ndihmës radiograf	K3	1
Ndihmës mikrobiolog	K3	1
N/T (Pathologjisë)	K3	1
N/T (Pathologjisë)	K3	1

Shkrues	Kə	1
Kuzhinier	Kə	1
N/T (Kirurgji)	Kə	1
Ndihmësradiograf	Kə	1
Ndihmësmikrobiolog	Kə	1
Ndihmësdentist	Kə	1
Ndihmësfarmacist	Kə	1
Ndihmësinfermier (Kirurgji)	Kə	1
Mikrobiol	Kə	1
Ndihmësinfermier (Kirurgji)	Kə	2
N/T (Kirurgji)	Kə	1
Shkrues	Kə	1
Kuzhinier	Kə	1
O/A	Kə	1
O/A	Kə	1
Totali		28
Numri i përgjithshëm		41

Vërejtje: Në vend të nënoficerëve mund të vendosen dhe ushtarë.

L I G J
Nr.9029, datë 13.3.2003

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8950, DATË 10.10.2002
“PËR GJENDJEN CIVILE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 8, pas fjalëve “raportet e atësisë dhe mëmësisë” shtohet fjala “kombësia”.

Neni 2

Në nenin 10, në fjalinë e parë, pas fjalës "mëmësisë" shtohet fjala "kombësia".

Neni 3

Në nenin 35, në pikën 3, pas shkronjës "f" shtohet shkronja “f/1” si më poshtë:

“f/1) kombësia në përputhje me kombësinë e prindërve, sipas Regjistrit Themeltar ekzistues para miratimit të këtij ligji dhe sipas kërkesave të tij.”.

Neni 4

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1 si më poshtë:

"Neni 37/1

Kombësia

1. Foshnja merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë të dokumentuar në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur sipas ligjit vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë për ndryshimin e atësisë ose mëmësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor.

2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, foshnjës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje, ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të foshnjës atë të të atit. Përfundimisht, kombësia e foshnjës në Regjistrin Themeltar shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës kur ai bëhet madhor.

3. Foshnja e lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia e saj, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

4. Foshnja e gjetur, që nuk i dihen prindërit, prezumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e pikës 2 të këtij neni.

5. I birësuari merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, por kur ai bëhet madhor, ka të drejtën të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit natyrorë.

6. I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur në çdo rast si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur sipas këtij neni, kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material.

8. Ndryshimi i kombësisë shqiptare të shtetasve shqiptarë nga organe të huaja është absolutisht i pavlefshëm.

Neni 5

Në nenin 44, në shkronjën “c”, në fund shtohet fjala “dhe kombësia”.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për mënyrën e evidentimit dhe regjistrimit të kombësisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3755, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9030, datë 13.3.2003

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8240, DATË 10.4.1997 “KODI PENAL
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8279,
DATË 15.1.1998 DHE ME LIGJIN NR.8733, DATË 24.1.2001**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 e 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8240, datë 10.4.1997 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998 dhe me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 bëhet kjo shtesë:

Në kreun VIII "Krime kundër autoritetit të shtetit", seksionin II "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik", pas nenit 257 shtohet një nen 257/a si më poshtë:

“Neni 257/a

**Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë
i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë**

Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3756, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M
Nr.196, datë 20.3.2003

**PËR STANDARDET E ZHVILLIMIT TË KURRIKULAVE TË ARSIMIT
DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Arsimit

dhe të Shkencës dhe Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Strukturat e kurrikulave të kualifikimeve profesionale (profileve dhe e specialiteteve) për nivele të ndryshme, që ofrohen në shkollat teknike e profesionale, publike, si dhe në qendrat publike të formimit profesional, të jenë si më poshtë vijon:

A. Kurrikula në nivel qendror, si standard kombëtar i kualifikimit profesional përkatës, përmban:

- a) emërtimin e kualifikimit profesional;
- b) qëllimet e përgjithshme të kualifikimit profesional;
- c) përshkrimin e përgjithshëm të veçorive të kualifikimit profesional (strukturën e kualifikimit, kohëzgjatjen, vendin që zë në strukturën e kualifikimeve profesionale kombëtare, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm);
- ç) kriteret e përgjithshme të pranimit për kualifikimin përkatës;
- d) listën e njohurive, shprehive e qëndrimeve, që do të përvetësohen nga nxënësi ose kursanti gjatë periudhës së kualifikimit;
- dh) përmbajtja e përgjithshme (lëndët, temat, modulet mësimore) dhe synimet përkatëse;
- e) shpërndarja kohore për elemente të përmbajtjes;
- ë) kriteret e përgjithshme të vlerësimit të nxënësit ose kursantit, si dhe të provimeve përfundimtare dhe të pjekurisë;
- f) llojin e dëshmisë (dëftesë, diplomë, certifikatë) me të cilën pajiset nxënësi ose kursanti pas përfundimit të kualifikimit përkatës;
- g) udhëzimet e përgjithshme dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të kualifikimit profesional përkatës.

B. Kurrikula në nivel shkolle ose qendre, e cila bazohet në kurrikulën e nivelit qendror përkatës, përmban:

- a) programet e hollësishme të lëndëve teorike dhe praktike ose moduleve të kualifikimit profesional përkatës, si dhe radhën e zhvillimit të tyre;
- b) objektivat e veçanta (rezultatet e pritshme) në procesin mësimor;
- c) shpërndarja kohore për elementet e hollësishme të përmbajtjeve;
- ç) mënyrat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të nxënësit ose kursantit;
- d) kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës porosit, financon dhe miraton kurrikulat e nivelit qendror për kualifikimet profesionale të ofruara nga shkollat teknike e profesionale, publike, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja "A".

3. Shkollat publike, teknike dhe profesionale, hartojnë kurrikulën në nivel shkolle, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja "B". Verifikimi dhe miratimi i kurrikulës bëhet nga një bord këshillimor, me specialistë të zgjedhur nga drejtoria arsimore dhe drejtoria e shkollës.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale porosit, financon dhe miraton kurrikulat e nivelit qendror të kualifikimeve profesionale, që ofrojnë qendrat publike të formimit profesional, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja "A".

5. Qendrat publike të formimit profesional hartojnë kurrikulën në nivel qendre në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja "B". Verifikimi dhe miratimi i kurrikulës bëhet nga një bord këshillimor, me specialistë të zgjedhur nga drejtoria arsimore dhe drejtoria e qendrës.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale mund të bëjnë rishikimin e kurrikulave përkatëse, të nivelit qendror për t'iu përgjigjur ndryshimeve të profesioneve.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.211, datë 28.3.2003

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR BOGOVË-ÇOROVODË, NË
QARKUN E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga rehabilitimi i segmentit rrugor Bogovë-Çorovodë, në qarkun e Beratit, ndërtim i cili ka filluar në vitin 2001 dhe do të përfundojë në dhjetor të vitit 2003.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 13 138 m² tokë arë, 438 m², tokë truall, 100 m² ndërtesë klub, 349 copë rrënjë ullinj, dru frutorë dhe hardhi, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 9 168 150 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale janë në vlerën 753 000 (shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë.

5. Fondi prej 9 921 150 (nëntë milionë e nëntëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda datës 30.4.2003.

7. Pagesat të kryhen sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë.

8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
RRETHI SKRAPAR
KOMUNA : BOGOVE DHE QENDER

Lista e pronareve qe shpronsohen per efekt te rehabilitimit te rruges
Bogove-Corovode

Lloji i pasurise se paluajtshme : Toke bujqesore, Truall, Objekte, Dru Frutor (1 - 75)

				Nr.i Aktit te pronesise.	Toke	Bujqesore		Truall			Objekte		
Nr	Emer	Atesia	Mbiemer		Sip m2	Cmim	Vlera	Sip (m2)	Cmimi	Vlera	Sip m2	Cmim	Vlera
1	Belul	Zylyftar	Nako	39/5,39/1	169	500	84500						
2	Sadik	Hazis	Guri	39/2	281	500	140500						
3	Lfter	Sadik	Guri	39/3	80	500	40000						
4	Neki	Sadik	Guri	39/4	547	500	273500						
5	Gramoz	Brahim	Hasani	39/7	160	500	80000						
6	Behar	Novruz	Baze	39/8	184	500	92000						
7	Ndertim	Pelivan	Qorri	34/20	230	500	115000						
8	Mustafa	Hekuran	Hoxha	34/19	240	500	120000						
9	Pellumb	Ali	Baze	30/6	210	500	105000						
10	Shefqet	Abdurrahman	Baze	30/5	311	500	155500						
11	Faik	Rexhep	Turhani	30/12	371	500	185500						
12	Ylli	Hamza	Caka	48/31	172	500	86000						
13	Skender	Neim	Mece	63/1	200	500	100000						
14	Qazim	Dalip	Hysi	48/29	240	500	120000						
15	Asim	Qani	Shabani	63/3	568	500	284000						
16	Zeni	Myrteza	Hasani	98	240	500	120000						
17	Murat	Tufan	Alushani	99/37	120	500	60000						
18	Krenar	Demir	Gjoka	99/33	285	500	142500						
19	Esat	Abdurrahman	Hasani	99/32	120	500	60000						
20	Flamur	Njazi	Berhami	110/1	240	500	120000						
21	Tomorr	Myrteza	Hasani	110/24	110	500	55000						

22	Agim	Teki	Hasani	99/30	220	500	110000						
23	Ramiz	Vrenoz	Cuni	72	210	500	105000						
24	Tahir	Nazmi	Kalluci	48/98	80	500	40000						
25	Bilbil	Teki	Hasani	39/6	75	500	37500						
26	Qemal	Izet	Dashi	301/25	112	500	56000						
27	Qemal	Izet	Dashi	301/25		500	0	300	1000	300000			
28	Barjam	Zylyftar	Zylyftari	67/1,144/5, 62/3	370	500	185000						
29	Sabri	Zylyftar	Zylyftari	67/2,124/1, 62/1	547.5	500	273750						
30	Jonuz	Fejzo	Zylyftari	67/3,144/3, 62/4	349	500	174500						
31	Esat	Fejzo	Zylyftari	144/4, 62/5	177.5	500	88750						
32	Syri	Qani	Zylyftari	141/2	30	500	15000						
33	Bashkim	Zylyftar	Zylyftari	62/2	60	500	30000						
34	Sulejman	Zylyftar	Zylyftari	62/6 ;148 ;67/5	620	500	310000						
35	Hamid	Kamber	Babaliu	333/6	86	500	43000						
36	Vesel	Kalem	Malo	333/7	28	500	14000						
37	Barjam	Kalem	Malo	333/8	40	500	20000						
38	Bektash	Kalem	Malo	333/9	32	500	16000						
39	Bardhyl	Iljaz	Cela	322/12, 323/18	198	500	99000						
40	Riza	Njazi	Malo	333/10	162	500	81000						
41	Kamber	Hamit	Babaliu	322/4	80	500	40000						
42	Ramo	Hasan	Babaliu	333/2, 322/5	70	500	35000						
43	Jetnor	Vaip	Babaliu	333/4; 322/6	59	500	29500						
44	Muhamet	Murat	Babaliu	322/7	32	500	16000						
45	Muhamet	Islam	Myftari	322/8 ; 248/14,15	133	500	66500						
46	Bardhyl	Qemal	Gode	323/8	34	500	17000						
47	Ylli	Sabri	Cela	322/16, 323/12	175	500	87500						
48	Tomorr	Neki	Myftari	315/13	48	500	24000						
49	Muhamet	Qemal	Gode	315/10, 323/7	99	500	49500						
50	Lefter	Qemal	Gode	315/7	230	500	115000						
51	Avenir	Myslim	Baze	309/3	110.5	500	55250						
52	Durim	Shkelqim	Kapllani	248/11 ;283/6	501	500	250500						
53	Baftjar	Shefit	Cela	283/4	108	500	54000						
54	Fatmir	Tefik	Kapllani	264/10,248/10	479	500	239500						
55	Edmond	Fatmir	Kapllani	281/17	306	500	153000						
56	Shpetim	Muharrem	Kapllani	264/11,248/4	352	500	176000						
57	Sefedin	Qazim	Spahiu	265/3	240	500	120000						
58	Guxim	Dule	Kapllani	264/7,248/5	106	500	53000						
59	Ylli	Sefedin	Kapllani	264/5	190	500	95000						
60	Perparim	Hysni	Kapllani	248/8	36	500	18000						
61	Defrim	Ajaz	Myftari	82	260	500	130000						
62	Sali	Nuri	Qafoku	187	140	500	70000						
63	Fejzo	Hasan	Qafoku	178	160	500	80000						
64	Ilmi	Sadik	Kapllani	323/6	13	500	6500						
65	Kamber	Shyqyr	Cela	323/11	10	500	5000						
66	Idriz	Ramadan	Kapllani	323/5	11	500	5500						
67	Adem	Sami	Kapllani	323/9	33	500	16500						
68	Agim	Murat	Babaliu	333/1	90	500	45000						

69	Teki	Xhelal	Babaliu	333/5	72	500	36000						
70	Kujtim	Islam	Myftari	322/9	200	500	100000						
71	Sulo	Muharrem	Kapllani	264/17	210	500	105000						
72	Ylli	Shasho	Zaimi	1/6		500	0	138	1000	138000			
73	Engjell	Osman	Karemani	307/9		500	0				100	19203	19203
74	Sefedin	Qazim	Spahiu										
75	Hysen		Hasani		75	500	37500						
	Shuma :				13138		6568750	438		438000	100		19203

Shuma totale e shpronesimit 9.168.150 leke

Shpenzime procedurale 753.000 leke

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 2.4.2003

Doli nga shtypi më 3.4.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë